

Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës, në bazë të nenit 28 dhe nenit 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 145/10, 136/11, 41/2014, 53/16, 83/18 dhe “Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr. 208/24 dhe 16/25), dhe duke vepruar sipas njoftimit për përqendrim të parashtruar nga Everlens SE, me seli në adresën Stadtbachstraße 1, 86153 Augsburg, Gjermani, përmes Lupka Noveska Andonova, avokate nga Shkupi, në seancën e mbajtur më datë 12.02.2026, miratoi këtë:

AKTVENDIM

1. Konstatohet se përqendrimi me të cilin Everlens SE, me seli në adresën Stadtbachstraße 1, 86153 Augsburg, Gjermani, do të fitojë kontroll mbi Everlens Muscat L.L.C., me seli në adresën Ndërtesa nr. 258/258A, parcela nr. 55, Rusayl Industrial Estate, Muskat, Sulltanati i Omanit, përmes shitblerjes së pjesës, edhe pse bie nën dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës, nuk do të ketë si pasojë parandalimin, kufizimin ose shtrembërimin e konsiderueshëm të konkurrencës efektive në treg ose në një pjesë thelbësore të tij, veçanërisht si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese të pjesëmarrësve, **dhe është në përputhje me dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës në kuptim të nenit 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës.**

2. Detyrohet parashtruesi i njoftimit për përqendrim të paguajë taksë administrative për njoftimin për përqendrim në vlerë prej 6.000,00 den. dhe për aktvendimin në vlerë prej 30.000,00 den., sipas numrit tarifor 34 të Ligjit për taksat administrative (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 17/93, 20/96, 7/98, 13/01, 24/03, 19/04, 61/04, 95/05, 7/06, 70/06, 92/07, 88/08, 130/08, 6/10, 145/10, 17/11, 84/12, 192/15, 23/16 dhe “Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr. 151/21) në llogarinë e Buxhetit të Republikës së Maqedonisë nr. 100000000063095, llogaria e pagesës 840...03161, shifra e të ardhurave dhe programi 72231300.

3. Padia për ngritjen e kontestit administrativ nuk e shtyn ekzekutimin e aktvendimit.

A r s y e t i m

Në përputhje me dispozitat e nenit 15 të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës (në tekstin e mëtejshëm: Ligji), më datë 16.01.2026, në Komisionin për Mbrojtjen e Konkurrencës (në tekstin e mëtejshëm: Komisioni) u dorëzua njoftim për përqendrim nga Everlens SE, me seli në adresën Stadtbachstraße 1, 86153 Augsburg, Gjermani, me të cilin Everlens SE do të fitojë kontroll mbi Everlens Muscat L.L.C., me seli në adresën Ndërtesa nr. 258/258A, parcela nr. 55, Rusayl Industrial Estate, Muskat, Sulltanati i Omanit, përmes shitblerjes së pjesës.

Komisioni filloi me shqyrtimin e Njoftimit në ditën e pranimit të tij dhe, në bazë të të dhënave të dorëzuara në Njoftimin për përqendrim dhe shtojcave të tij, konstatoi sa vijon:

Aktivitetet kryesore afariste të ndërmarrjeve të përfshira:

Everlens SE është një kompani inxhinierike gjermane e specializuar për sisteme lëvizëse dekarbonizim dhe zgjidhje për efikasitet për industrinë detare, sektorin e energjisë dhe aplikimet industriale. Everlens SE është shoqëri e varurtë indirekt e Volkswagen Aktiengesellschaft, e cila është shoqëria mëmë e Grupit Volkswagen.

Grupi Volkswagen është aktiv në nivel global në zhvillimin, prodhimin, marketingun dhe shitjen e veturave për pasagjerë, automjeteve të lehta komerciale, kamionëve, autobusëve, autobusëve turistikë, shasive për autobusë dhe motorëve me naftë, motoçikletave, duke përfshirë secila pjesë rezervë dhe aksesorë. Grupi Volkswagen është aktiv edhe në shpërndarjen e automjeteve.

Grupi Volkswagen përfshin markat e automjeteve motorike Volkswagen, Volkswagen Commercial Vehicles, Porsche, Audi, Škoda, Bentley, Lamborghini, SEAT, Cupra, MAN, Scania dhe Ducati. Për më tepër, Volkswagen ka themeluar nën-markën MOIA, një ofrues i shërbimeve teknologjike që fokusohet në një model të bazuar në platformë për ofrimin e lëvizshmërisë autonome gjatë transportit si shërbim (*mobility as a service - MaaS*).

Grupi Volkswagen është i pranishëm në Maqedoninë e Veriut përmes shoqërive të varura të mëposhtme:

- Porsche Leasing SHPKNJP Shkup, me seli të regjistruar në Bul. “Bosnja dhe Hercegovina” nr. 3, Shkup, me veprimtari prioritare 64.910 – qiradhënie financiare (lizing);
- Porsche Broker SHA Shkup, me seli të regjistruar në Bul. “Bosnja dhe Hercegovina” nr. 3, Shkup, me veprimtari prioritare 66.220 – veprimtaritë e agjentëve të sigurimeve dhe ndërmjetësve të sigurimeve;
- Scania Maqedoni SHPKNJP Shkup, me seli të regjistruar në rr. “34” nr. 7 Ilinden, Shkup, me veprimtari prioritare 46.710 – tregti me shumicë e automjeteve motorike; dhe
- Porsche Maqedoni SHPKNJP Shkup, me seli të regjistruar në Bul. “Bosnja dhe Hercegovina” nr. 4, Shkup, me veprimtari prioritare 46.710 – tregti me shumicë e automjeteve motorike.

Everlens Muscat L.L.C. është një shoqëri e themeluar si sipërmarrje e përbashkët (joint venture) e themeluar dhe në pronësi të Everlens SE dhe grupit OPES/OHI. Everlens Muscat L.L.C., vepron në Oman si shoqëri e lidhur vendase e Everlens SE dhe shërben si qendër rajonale e Everlens SE për menaxhimin e projekteve, shitjet dhe mbështetjen teknike, si dhe funksionon si një qendër koordinimi për projektet e Everlens SE për shërbimet detare dhe prodhimin e energjisë. Everlens Muscat L.L.C. ofron gjithashtu shërbime të pas-shitjes siç janë inxhinieria, mbështetja në terren dhe zgjidhjet e mirëmbajtjes për sistemet lëvizëse detare dhe impiantet e prodhimit të energjisë. Gjithashtu, Everlens Muscat L.L.C. kryen furnizimin me komponentë rezervë industriale (p.sh. kushineta, boshte).

Everlens Muscat L.L.C. nuk është e pranishme në Maqedoninë e Veriut, dhe nuk ka realizuar asnjë të ardhur në Maqedoninë e Veriut në vitin 2024.

Komisioni konstatoi se përqendrimi i njoftuar bie nën dispozitat e Ligjit, pasi plotëson kushtet nga neni 12 paragrafi (1) dhe nga neni 14 paragrafi (1) pika 1) dhe 2) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës.

Komisioni, duke marrë parasysh kriteret nga neni 17 paragrafi (2), paragrafi (3) dhe paragrafi (4) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe pikës 6 b) të *Udhëzimeve për përcaktimin e rasteve në të cilat gjatë vlerësimit të përqendrimeve Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës zakonisht do të konstatojë se të njëjtat janë në përputhje me Ligjin për Mbrojtjen e Konkurrencës*, vlerësoi se përqendrimi i njoftuar, megjithëse bie nën dispozitat e Ligjit, është në përputhje me të pasi nuk do të ketë si pasojë pengimin, kufizimin ose cenimin e

konsiderueshëm të konkurrencës efektive në treg ose në një pjesë thelbësore të tij, veçanërisht si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese të pjesëmarrësve.

Duke marrë parasysh këtë vlerësim të përqendrimit, Komisioni vendosi si në dispozitivin e këtij Aktvendimi, në përputhje me nenin 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit.

Në përputhje me nenin 53 paragrafi (2) të Ligjit, padia nuk e shtyn ekzekutimin e aktvendimit.

Udhëzim për mjetin juridik:

Kundër këtij aktvendimi mund të paraqitet padi për ngritjen e kontestit administrativ pranë Gjykatës Administrative në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimi të aktvendimit.

**KOMISIONI PËR MBROJTJEN E KONKURRENCËS
KRYETARE**

Mr. Малинка Силјановска Николиќ